

## Ja si do bëhet aplikimi për në Universitet, shanset për të fituar

*Publikohet manuali i maturanit për vitin 2016.*

Në këtë manual është zbardhur e gjithë procedura që duhet të ndjekin kandidatët për të aplikuar. Pas hedhjes në sistem të mesatareve të të gjithë maturanëve që dëshirojnë të garojnë për të fituar një të drejtë studimi nga ato që ofrohen nga IAL-të shtetërore dhe private për vitin akademik 2016-2017, sistemi online i Maturës Shtetërore hapet sipas një plani kalendar të publikuar më parë për të gjitha DAR/ZA-të e vendit.

Të gjithë maturanët/kandidatët që e kanë realizuar hapin e parë të kësaj procedure mund të aksesohen në sistem me kredencialet e tyre, të cilat po i paraqesim më poshtë: ID e maturanit, emri, atësia, mbiemri, kartë e identitetit dhe e-maili i maturanit.

Pas identifikimit me kredencialet e mësipërme në çdo mjedis ku ka akses interneti si shkollë, zyrë, kafe interneti, smart phone, etj. maturanit/kandidatit i jepet mundësia që të zgjedhë jo më shumë se 10 programe studimi nga lista e këtyre programeve që ofrohen nga IAL-të shtetërore dhe private për vitin akademik 2016-2017. Nëse maturanit aplikues e ka mesataren e futur në sistem nga sekretaritë mësimore të shkollave të mesme  $<6.0$  atëherë ai mund të përzgjedhë vetëm programet e studimit dy vjeçare (profesionale) që ofrohen nga disa universitete shtetërore dhe private.

Nëse mesatarja e aplikuesit është  $\geq 6.0$  ai mund të përzgjedhë të gjitha programet e studimit të ofruar përveç atyre rasteve kur IAL-ja ka përcaktuar mesatare më të lartë pranisi si kriter hyrës për atë program studimi. Megjithatë vetë sistemi informatik jep mesazhe informuese në lidhje me mesataren e kërkuar kur aplikuesi përzgjedh.

Për të gjithë aplikantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, në momentin që plotësojnë mesataren duhet të evidentojnë këtë fakt (psh: me anë të një checkbox etj). Pasi të bëhet aplikimi me formularin e aplikimit për në IAL marrin një njoftim për ndjekjen e procedurave të mëtejshme. Edhe kjo kategori maturanësh duhet të fusë në sistem rezultatet shkollore (notat e të gjitha lëndëve) të viteve të arsimit të mesëm. Për këtë qëllim dhe ata duhen të paraqiten më 15 qershor 2016 pranë shkollave ku kanë bërë aplikimin me formularin A1Z, për të filluar procesin e plotësimit të bazës së të dhënave shkollore. Pas përfundimit të provimeve të maturës shtetërore 2016 si dhe aplikimit me Formularin e Aplikimit në IAL në Portalin Matura Shtetërore Online, AKP i përcjell IAL-ve për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre listën e maturanëve/kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me të gjitha notat e viteve të shkollimit të mesëm, rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore si dhe tregues vlerësimi të tjerë të nevojshëm për rankimin dhe shpalljen e fituesve nga ana e IAL-ve. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë publikojnë listat e rankuara të aplikantëve me të dhënat e

**maturashteterore2016.wordpress.com** përcjella nga AKP

për ta bërë procesin sa më transparent. Në këtë listë të publikuar me vijë të kuqe përcaktohet fituesi i fundit në varësi të kuotave të ofruara për atë program studimi.

### ***Regjistrimi i fituesve në IAL***

Aplikuesit që janë shpallur fitues në më shumë se një program studimi mund të regjistrohen në një dhe vetëm njërin nga programet e studimit në të cilët janë shpallur fitues. Për ta kontrolluar procesin e regjistrimit sipas kriterit të mësipërm, fillimisht në ambientet e sekretarive mësimore të fakulteteve do të kryhet regjistrimi paraprak online dhe pa dorëzim dokumentesh. Fituesit paraqiten me kartën e identitetit apo pasaportë biometrike pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku janë shpallur fitues (sipër vijës së kuqe të listave të rankuara). Sekretaritetë mësimore të IAL-ve kanë akses në Portalin e Maturës Shtetërore online për regjistrimin paraprak online të fituesve të shpallura nga Dekanatet e fakulteteve përkatëse.

Nëse një aplikant gjatë procesit të regjistrimit online rezulton se nuk është i regjistruar më parë në një program tjetër studimi sistemi informatik e pranon regjistrimin e tij paraprak. Në rast të kundërt i jepet njoftim nga sistemi që është i regjistruar në një program tjetër dhe nëse dëshiron mund të çregjistrohet nga i mëparshmi për t'u regjistruar në programin e dytë ku është shpallur fitues. E gjithë kjo procedurë regjistrim - çregjistrimesh do të bëhet në muajin shtator 2016. Pas kësaj faze fillon regjistrimi përfundimtar me dorëzim dokumentesh pranë sekretarive mësimore të fakulteteve. Studenti pas kësaj faze e humbet të drejtën e çregjistrimit dhe regjistrimit në një program tjetër studimi. Pas përfundimit të kësaj faze IAL-të verifikojnë dhe përcaktojnë kuotat e mbetura të paplotësuara, i publikojnë ato për çdo program studimi së bashku me listat e aplikuesve që në publikimin e mëparshëm shfaqeshin poshtë vijës së kuqe të fituesve. Më pas sekretaritetë mësimore fillojnë regjistrimin për plotësimin e kuotave të mbetura të paplotësuara, në të cilën mund të regjistrohen vetëm maturantët/ kandidatët poshtë vijës së kuqe, të cilët nuk janë të regjistruar në mënyrë përfundimtare (me dorëzim dokumentesh) në asnjë program studimi. Në këtë fazë maturantët/-kandidatët duhet të jenë mjaft të vëmendshëm për të kontaktuar dhe marrë informacion pranë sekretarive mësimore të fakulteteve.

**Maturashtetërore2016.wordpress.com**

### ***Aplikimi me Formularin e Aplikimit për kuota të veçanta në IAL***

Një risi tjetër e procesit të aplikimit për në IAL, këtë vit është aplikimi për kuota të veçanta nëpërmjet Portalit të Maturës Shtetërore online. Në kuotat e veçanta përfshihen kandidatët nga Trojet, Statusi i të verbrit, Statusi i jetimit, Romët, Ballkano Egjiptianët, studentë të huaj, etj. Për këto target grupe procesi i aplikimit kryhet sipas fazave të përshkruar më poshtë:

1. Aplikimi i formularit A1Z kryhet në fund të muajit gusht.
2. Plotësimi i Formularit të Aplikimit për kuota të veçanta në IAL kryhet në mesin e muajit shtator. Për të qenë të sigurt që aplikimin e këtij formulari e bëjnë kandidatët që janë pjesëtarë të këtyre grupimeve, aplikimet bëhen në mjedise të autorizuar nga MAS, në prezencë të mbikëqyrësve të autorizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ky aplikim do të ketë të njëjtat

procese si faza e mëparshme e aplikimit, por do të zhvillohet me vetëm një regjistrim (me dokumente pranë sekretarive mësimore të fakulteteve). Rankimi do të bëhet sipas kriterit të mesatares.

### ***Plotësimi i formularit të aplikimit në IAL për kuotat boshe***

Plotësimi i këtij formulari është i lejuar për maurantët e paregjistruar me dokumente në ndonjë program studimi në fazat e mëparshme dhe bëhet në fund të procesit për të plotësuar kuotat e mbetura boshe për shkak të mos përzgjedhjes nga kandidatët të këtyre programeve të studimit në fazën e parë të aplikimit. Shërben për të plotësuar kryesisht kuotat e programeve të studimit të ofruara nga Universitetet e rretheve (jo shumë të preferuara) si dhe të IAL-ve private.

Mauranti/ kandidati në këtë fazë aplikimi bën 10 përzgjedhje preferencash të ndryshme nga ato që ka bërë më

parë. a. Ky formular do të plotësohet nga studentë të cilët gjenden në DB e maturës dhe nuk rezultojnë të regjistruar. b. Nuk rezultojnë mbetës viti dhe mbetës në provimet e Maturës Shtetërore. c. Maurantët/kandidatët aplikojnë me 10 preferenca të reja pa marrë parasysh aplikimin e mëparshëm. Ky aplikim do të ketë të njëjtat procese si faza e mëparshme e aplikimit, por do të zhvillohet me vetëm një regjistrim (me dokumente pranë sekretarive mësimore të fakulteteve). Rankimi do të bëhet sipas kriterit të përcaktuara me vendim senatesh të IAL-ve.

# **Matura Shtetërore 2016**

— [Maturashteterore2016.wordpress.com](http://Maturashteterore2016.wordpress.com) —